

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 5805 REP.
NR. 2013 KOL.



**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ANONIME PA OFERTË PUBLIKE
“UNI-COM SH.A.”**

Sot më datë 05.09.2006, përpara meje Noteres Znj. A. Mallume, u paraqit:

- **UNION GRUP SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 26016, datë 25.06.2001, me seli në Bulevardin “Zogu I”, pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë, ligjërisht e përfaqësuar në këtë akt nga Z. Niko Leka, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 31 Mars 1961, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Z0229907, sipas Vendimit të Asamblesë së Zakonshme të shoqërisë së mësipërme datë 05.09.2006,

e cila, në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 14.12.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka vendosur të krijojë një shoqëri anonime pa ofertë publike të emërtuar “UNI-COM” Sh.A., (këtëj e tutje referuar edhe si “Shoqëria”) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj i cili formon pjesë përbërëse të këtij Akti Themelimi.

Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë

Është themeluar një shoqëri anonime, me emërtimin “Uni-Com” Sh.A.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Bulevardin “Zogu I”, pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Shoqëria do të ofrojë të gjitha shërbimet, të lejuara dhe/ose të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, në fushën e telekomunikacionit, shërbime të cilat Shoqëria mund ti ofrojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar vetëm në to, aktiviteti i Shoqërisë ka për objekt:

- 
- (a) ofrimin e shërbimeve publike telefonike, të palëvizshme dhe të lëvizshme në shkallë kombëtare;
 - (b) ofrimin e shërbimeve publike telefonike në zonat rurale, shërbime radioje dhe të kërkimit të personit (paging), shërbimeve globale të komunikimeve vetjake të lëvizshme si dhe ofrimin e çdo shërbimi që përdor spektrin e radiofrekuencave;
 - (c) ofrimin e shërbimeve me qëllim mundësimin e aksesit në Internet (ISP), ofrimin e shërbimeve të transmetimit të të dhënave, shërbimeve me vlerë të shtuar, shërbimeve të multimedias dhe ISDN, komunikimeve me teletekst dhe videotekst, shërbimeve të telefonave publike me monedha, karta krediti apo karta të parapaguara; dhe
 - (d) projektimin dhe instalimin e sistemesh dhe rrjetesh telekomunikacioni.

4.2 Shoqëria ka të drejtë të kryejë çdo veprimtari ndihmëse apo veprimtari tjetër që lidhet me përmbushjen e objektit të saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 5 - Kapitali i Shoqërisë – Kontributet

- 5.1 Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i paguar i Shoqërisë është 10.000.000 Leke (dhjetë milion Lekë) i cili përbëhet nga 10.000 (dhjetë mijë) aksione me vlerë nominale prej 1.000 Leke (një mijë Leke) për aksion. Çdo aksion është i pandashëm dhe siguron të drejtën e një vote.
- 5.2 Në momentin e themelimit, kapitali i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:
 - 1 **Union Grup Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 26016, datë 25.06.2001, me seli në Bulevardin “Zogu I”, pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë, i cili ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 10.000.000 Leke (dhjetë milion leke).
- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, në momentin e themelimit:
 - **Union Grup Sh.p.k.** zotëron 10.000 (dhjetë mijë) aksione, të barabarta me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.

Neni 6 - Aksionet

Aksionet e Shoqërisë mund të transferohen tërësisht apo pjesërisht sipas procedurave të parashikuara në Nenin 7 të Statutit.

Neni 7 – Përbërja dhe Emërimi i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

- 7.1 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve emërohen nga Asambleja e Aksionerëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve emërohet nga punëmarrësit e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 7.2 Si përjashtim nga rregulli i mësipërm, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës janë personat e mëposhtëm:
 - (a) Kryetar i Këshillit Mbikqyrës: Z. Edmond Leka, qytetar shqiptar, lindur në



Tirane, më 17 Maj 1963, banues në Tirane, mbajtës i pasaportës me nr. Z0789892.

(b) Nën-Kryetar i Këshillit Mbikqyrës: Z. Niko Leka, qytetar shqiptar, lindur në Tirane, më 31 Mars 1961, banues në Tirane, mbajtës i pasaportës me nr. Z0229907.

(c) Anëtar i Këshillit Mbikqyrës: Z. Varuzhan Piranjani, qytetar shqiptar, lindur në Tirane, më 22 Mars 1957, banues në Tirane, mbajtës i pasaportës me nr. Z1494681.

7.3 Afati i qëndrimit të tyre në detyrë është 6 (gjashtë) vjet dhe ata të gjithë mund të rizgjidhen.

Neni 8 – Përbërja dhe Emërimi i Anëtarëve të Drejtorisë

8.1 Shoqëria drejtohet nga një Drejtori e përbërë nga një numër prej 1 (një) ose 3 (tre) Drejtorësh, të cilët mund të jenë ose jo aksionerë, të emëruar nga Këshilli Mbikqyrës. Drejtori i parë dhe i vetëm i Shoqërisë është: Z. Genond Mesareja, qytetar shqiptar, lindur në Tirane, më 21 Korrik 1969, banues në Tirane, mbajtës i pasaportës me nr. Z1379870.

8.2 Drejtorët emërohen për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Neni 9 – Kontrollorët

9.1 Kontrolli i brendshëm i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, dhe në mungesë të tij nga zëvendësuesi i tij, të cilët emërohen nga Asambleja e Zakonshme për një vit financiar

9.2 Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi: ekspert kontabël i autorizuar është: Bujar Bendo, qytetar shqiptar, lindur në Lushnjë, më 02 Korrik 1966, banues në Rr. Perlat Rexhepi, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës me nr. Z1111038 dhe me licencë profesionale nr. 79, datë 20 Maj 2000; dhe

Neni 10 - Dispozitë Përfundimtare

Për ç'farë nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi mbi shoqëritë tregtare.

Palët deklarojnë se ky Akt Themelimi është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruajnë atë në praninë time, Noteres, në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë Noterja vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Në emer dhe për llogari të
UNION GRUP SH.P.K.

Niko Leka
Niko Leka
Rr. Bul. Zvezda Pashall St. Tiranë
TIRANë - ALBANIë
NIPT K 61527801 R



NOTERE
ARJAN MALLKUCI
Tel. Zyre 250223, 266242

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 5806 REP.

NR. 2049 KOL.



STATUTI
I SHOQËRISË ANONIME PA OFERTË PUBLIKE
“UNI-COM SH.A.”

Sot më datë 05.09.2006, përpara meje Noteres Znj. A. Balliu, u paraqit:

- **UNION GRUP SH.P.K.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 26016, datë 25.06.2001, me seli në Bulevardi “Zogu I”, pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë, ligjërishit e përfaqësuar në këtë akt nga Z. Niko Leka, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 31 Mars 1961, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Z0229907, sipas Vendimit të Asamblesë së Zakonshme të shoqërisë së mësipërme datë 05.09.2006,

i cili, në përputhje me Ligjin nr. 7638, datë 14.12.1992 “Për Shoqëritë Tregtare” dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ka vendosur të krijojë një shoqëri anonime pa ofertë publike të emërtuar “Uni-Com” Sh.A., (këtë e tutje referuar edhe si “Shoqëria”) dhe për këtë qëllim bie dakort se aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut.

TITULLI I
EMËRTIMI I SHOQËRISË – SELIA – KOHËZGJATJA - OBJEKTI

Neni 1 - Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Uni-Com Sh.A. ose shkurt, UC (në vijim referuar si “Shoqëria”) është themeluar në formën e një shoqërie anonime pa ofertë publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 1.2 Shoqëria është pjesë e UNION Grup. Në këtë cilësi, për administrimin dhe veprimtaritë bashkërenduese, Shoqëria detyrohet të zbatojë rregullat që shoqëria mëmë miraton për zbatimin e akteve në interes të stabilitetit të grupit. Organet drejtuese të Shoqërisë i japin shoqërisë mëmë çdo të dhënë dhe informacion të nevojshëm për miratimin e këtyre rregullave, si dhe çdo të dhënë apo informacion që ka lidhje me veprimtarinë e saj dhe të shoqërive të saj si pjesë e grupit.

Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Bulevardi “Zogu I”, pallati 13 katësh, përballë Stacionit të Trenit, Tiranë.

- 2.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të hapë ose mbyllë, degë dhe/ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.
- 2.3 Përsa i përket marrëdhënieve midis Shoqërisë dhe aksionerëve, vendqëndrimi i secilit prej aksionerëve është ai i përcaktuar në regjistrin e aksionerëve.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4 - Objekti

- 4.1 Shoqëria do të ofrojë të gjitha shërbimet, të lejuara dhe/ose të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, në fushën e telekomunikacionit shërbime të cilat Shoqëria mund ti ofrojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar vetëm në to, aktiviteti i Shoqërisë ka për objekt:
- (a) ofrimin e shërbimeve publike telefonike, të palëvizshme dhe të lëvizshme në shkallë kombëtare;
 - (b) ofrimin e shërbimeve publike telefonike në zonat rurale, shërbime radioje dhe të kërimit të personit (paging), shërbimeve globale të komunikimeve vetjake të lëvizshme si dhe ofrimin e çdo shërbimi që përdor spektrin e radiofrekuencave;
 - (c) ofrimin e shërbimeve me qëllim mundësimin e aksesit në Internet (ISP), ofrimin e shërbimeve të transmetimit të të dhënave, shërbimeve me vlerë të shtuar, shërbimeve të multimedias dhe ISDN, komunikimeve me teletekst dhe videotekst, shërbimeve të telefonave publikë me monedha, karta krediti apo karta të parapaguara; dhe
 - (d) projektimin dhe instalimin e sistemesh dhe rrjetesh telekomunikacioni.
- 4.2 Shoqëria ka të drejtë të kryejë çdo veprimtari ndihmëse apo veprimtari tjetër që lidhet me përmbushjen e objektit të saj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

TITULLI II KAPITALI – AKSIONET

Neni 5 - Kapitali i Shoqërisë

- 5.1 Kapitali i nënshkruar dhe plotësisht i paguar i Shoqërisë është 10.000.000 Leke (dhjetëmilion leke) i cili përbëhet nga 10.000 (dhjetëmijë) aksione me vlerë nominale prej 1.000 Leke (njëmijë Leke) për aksion.
- 5.2 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të rrisë kapitalin e saj nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja apo nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve ekzistuese. Në rast të rritjes së kapitalit me aksione të reja, ato do ti ofrohen fillimisht aksionerëve ekzistues në përputhje me numrin e aksioneve të zotëruara prej tyre, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 5.3 Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, por kapitali në asnjë rast nuk mund të zbresë poshtë kufirit të parashikuar nga ligji. Përndryshe, Shoqëria duhet të transformohet në një formë tjetër.

Neni 6 – Aksionet & Regjistri i Aksionerëve

- 1 Çdo aksion është i pandashëm dhe jep të drejtën e një vote.
- 2 Pranë selisë së Shoqërisë mbahet një Regjistër i Aksionerëve, në të cilin duhet të shënohet numri i aksioneve të regjistruara në emër të secilit prej aksionerëve. Libri i Aksionerëve mbahet nga Drejtoria, e cila ka për detyrë të kryejë regjistrimet me kërkesë të personave të interesuar, me paraqitjen e një dokumenti që vërteton të drejtën e tyre. Çdo aksioner mund të kontrollojë Regjistrin e Aksionerëve dhe të tërheqë kopje të tij

Neni 7 – Transferimi i Aksioneve

- 1 Transferimi *inter vivos* i aksioneve të Shoqërisë personave të tretë i nënshtrohet të drejtës së parablerjes në favor të aksionerëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 (njëzet) ditësh nga marrja e letrës së dërguar me postë rekomande që përmban ofertën.
- 2 Përcaktimet që parashikohen në nenin 7.1 nuk do të zbatohen për shitjet dhe transferimet e aksione të kryera nga aksionerët në favor të aksionerëve të tjerë. Megjithatë, në këtë rast, transferimi duhet t'i njoftohet më parë aksionerëve të tjerë me shkrim. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë nen duhet t'i njoftohen edhe Shoqërisë.
- 3 Transferimi i titullit të pronësisë mbi aksionet, si dhe krijimi ose transferimi i çdo të drejte tjetër mbi to, regjistrohet në Regjistrin e Aksionerëve, i cili duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e aksionerit ose emërtimin e shoqërisë aksionere, si dhe adresat e banimit apo selinë e subjekteve që transferojnë, blejnë ose krijojnë të drejta mbi aksionet; numrin e aksioneve dhe vlerën e tyre; datën e marrëveshjes.

TITULLI III SEKSIONI I ORGANET E SHOQËRISË

Neni 8 – Organet e Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Aksionerëve;
2. Këshilli Mbikqyrës;
3. Drejtoria; dhe
4. Eksperti Kontabël.



SEKSIONI II ASAMBLEJA E AKSIONERËVE

Neni 9 - Asambleja e Aksionerëve

- 9.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Aksionerëve, e cila përbëhet prej të gjithë aksionerëve të Shoqërisë. Asambleja e Aksionerëve mund të jetë e Zakonshme apo e Jashtëzakonshme.

9.2/ Vendimet e marra me shumicën e votave nga Asambleja e Aksionerëve janë të detyrueshme për të gjithë aksionarët, pavarësisht nëse ata mungojnë apo votojnë kundër, përveç rastit të kundërshtimit të vendimit sipas afatit dhe procedurës të parashikuar me ligj.

Neni 10 – Aksioneri në Asamblenë e Aksionerëve

- 10.1 Çdo aksionar ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblenë e Aksionerëve, të shprehë mendimin e tij si dhe të përdorë atë numër votash që i korrespondon aksioneve që ai zotëron.
- 10.2 Çdo aksionar mund të përfaqësohet nga një aksionar apo person tjetër mbi bazën e një prokure të posaçme me shkrim për ushtrimin e së drejtës dhe përdorimit të votës së aksionarit.
- 10.3 Aksionari nuk mund të lëshojë prokurë për të votuar mbi një pjesë të aksioneve të tij në rast se ai voton personalisht për pjesën e mbetur të aksioneve të zotëruara prej tij.

Neni 11 – Thirrja e Asamblesë së Aksionerëve

- 11.1 Asambleja e Aksionerëve thirret nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose nga Drejtoria. Ajo mund të thirret gjithashtu në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 11.2 Thirrja e Asamblesë së Aksionerëve rregullohet nga legjislacioni në fuqi.
- 11.3 Asambleja e Aksionerëve konsiderohet e thirrur në mënyrën e duhur edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë procedurën e thirrjeve, me kusht që të gjithë aksionerët të jenë të pranishëm apo përfaqësohen me prokurë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 11.4 Aksionerët të cilët janë regjistruar që prej të paktën 5 (pesë) ditësh në Regjistrin e Aksionerëve dhe aksionerët të cilët depozitojnë aksionet e tyre në bazë të udhëzimeve dhe afateve të përcaktuara në njoftimin e thirrjes mund të marrin pjesë në Asamblenë e Aksionerëve.

Neni 12 – Mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve

- 12.1 Asambleja e Aksionerëve mund të mbledhet edhe në një vend të ndryshëm nga selia, brenda Shqipërisë ose jashtë saj.
- 

12.2 Asambleja e Aksionarëve mund të zhvillohet edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së personave që ndodhen në vende të ndryshme, të ndërlidhur me mjete telekomunikacioni të përshtatshme për komunikim kolektiv, në përputhje me parimet e mirëbesimit dhe të trajtimit të barabartë të aksionarëve. Në këtë rast:

- a) vendodhjet audio/video, ndërlidhja e së cilave është përgjegjësi e Shoqërisë, në të cilat ndodhen personat që do të marrin pjesë, përcaktohen në njoftim (përveç rastit kur mbledhja zhvillohet sipas nenit 11.3) dhe mbledhja konsiderohet e zhvilluar në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes së Asamblesë ose noteri i cili harton procesverbalin;
- b) Kryetari i mbledhjes së Asamblesë, edhe nëpërmjet zyrës së tij, duhet të jetë në gjendje të kontrollojë rregullsinë e zhvillimit të mbledhjes, të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e personave të pranishëm, të drejtojë zhvillimin e mbledhjes dhe të verifikojë rezultatet e votimeve;
- c) Sekretari i mbledhjes së Asamblesë ose noteri (nëse caktohet) që harton procesverbalin, duhet të jetë në gjendje të ndjekë në mënyrën e duhur zhvillimin e mbledhjes, e cila është objekt i pasqyrimit në procesverbal;
- d) Personat pjesëmarrës duhet kenë mundësinë për të marrë pjesë në diskutim dhe në votim të njëkohshëm për çështjet e përfshira në rendin e ditës.

Neni 13 – Kryesimi i Asamblesë së Aksionerëve

13.1 Të gjitha mbledhjet Asamblesë së Aksionerëve drejtohen nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës apo në vend të tij nga Zëvendës-Kryetari, ose, nëse këta persona nuk janë të disponueshëm, nga një Anëtar i Drejtorisë apo edhe nga një aksioner i emëruar nga Asambleja e Aksionerëve. Asambleja e Aksionerëve cakton një sekretar të mbledhjes, i cili mund të jetë ose jo aksioner.

13.2 Kryetari ka kompetenca të plota për të verifikuar prokurat dhe rregullsinë e tyre, të drejtën e aksionerëve dhe përfaqësuesve të tyre për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve dhe të vendosë nëse ajo është e mbledhur rregullisht dhe nëse është i pranishëm *quorum*-i i aksionerëve me qëllim që të merren vendime të vlefshme; ai ka gjithashtu të drejtën të drejtojë diskutimet dhe të përcaktojë metodat dhe procedurat e votimit.

13.3 Vendimet dhe/ose proces-verbalet e mbledhjeve nënshkruhen respektivisht nga Kryetari dhe Sekretari i Asamblesë dhe nënshkrimet e tyre mund të vërtetohen edhe nga një noter.

Neni 14 – Asambleja e Zakonshme

14.1 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve duhet të mbahet të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit financiar, me qëllim që të diskutohen, shqyrtohen dhe miratohen raportet financiare, llogaritë dhe bilanci i vitit të mëparshëm financiar.

14.2 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve mund të marrë çdo vendim përveç atyre që ligji ia rezervon mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të



Aksionerëve.

- 14.3 Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve quhet vlefshmërisht e mbledhur në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë aksionerët, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mund të mbahet një mbledhje e dytë, pa u kërkuar ndonjë *quorum*. Mbledhja e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve merr vendim me shumicën e aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 15 - Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme

- 15.1 Vetëm mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve mund të vendosë ndryshimin e Statutit.

- 15.2 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve quhet e thirrur vlefshmërisht në mbledhjen e saj të parë nëse marrin pjesë aksionerët, të pranishëm ose të përfaqësuar, të cilët zotërojnë të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe në mbledhjen e dytë nëse marrin pjesë aksionerët, të pranishëm apo të përfaqësuar, që zotërojnë të paktën 25% (njëzet e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.

- 15.3 Në rast se ky *quorum* nuk arrihet, mbledhja e dytë mund të shtyhet për një datë të mëvonshme, por jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e thirrjes së mbledhjes së parë.

- 15.4 Mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve vendos me një shumicë prej 3/4 (tre të katërtat) e aksionerëve, të pranishëm apo të përfaqësuar.

SEKSIONI III KËSHILLI MBIKQYRËS

Neni 16 – Përbërja dhe emërimi i snëtarëve të Këshillit Mbikqyrës

- 16.1 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve emërohen nga Asambleja e Aksionerëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve emërohet nga punëmarrësit e Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 16.2 Si përjashtim nga rregulli i mësipërm, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, anëtarët e parë të Këshillit Mbikqyrës janë personat e mëposhtëm:

- (a) Kryetar i Këshillit Mbikqyrës: Z. Edmond Leka, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 17 Maj 1963, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Z0789892;
- (b) Nën-Kryetar i Këshillit Mbikqyrës: Z. Niko Leka, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 31 Mars 1961, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Z0229907;
- (c) Anëtar i Këshillit Mbikqyrës: Z. Varuzhan Piranjani, qytetar shqiptar, lindur në Tiranë, më 22 Mars 1957, banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës me nr. Z1494681.



- 16.3 Afati i qëndrimit në detyrë të secilit anëtar të Këshillit Mbikqyrës është 6 (gjashtë) vjet dhe secili prej tyre mund të rizgjidhet . Anëtarët e emëruar nga Asambleja e Aksionerëve mund të revokohen për çfarëdo arsye nga Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve.
- 16.4 Në rast vdekje, shkarkimi apo dorëheqje, vendet vakant duhet të zëvendësohen brenda 3 (tre) muajve. Anëtar i Këshillit Mbikqyrës, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar tjetër, qëndron në detyrë për të gjithë kohën e mbetur të mandatit të anëtarit paraardhës.

Neni 17 – Kryetari dhe Zëvendës-Kryetari i Këshillit Mbikqyrës

- 17.1 Këshilli Mbikqyrës emëron nga anëtarët e tij një Kryetar dhe një Zëvendës-Kryetar, të cilët e kanë për detyrë të thërrasin mbledhjet e Këshillit dhe të drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre dhe mund të rizgjidhen.
- 17.2 Këshilli Mbikqyrës mund të emërojë një sekretar qoftë edhe jo nga gjiri i anëtarëve të tij.
- 17.3 Në rast mungese të Kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës drejtohen nga Zëvendës-Kryetari.

Neni 18 - Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

- 18.1 Këshilli Mbikqyrës mbledhet rregullisht të paktën një herë në tre muaj dhe sa herë që interesi i Shoqërisë e kërkon, me thirrjen e Kryetarit ose, në mungesë të tij, të Zëvendës-Kryetarit.
- 18.2 Kryetari duhet të thërrasë Këshillin Mbikqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa e motivuar e Drejtorisë ose të 1/3 (një të tretës) së anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës. Nëse kjo kërkesë mbetet pa përgjigje, kërkuuesi mund të thërrasë mbledhjen e Këshillit, duke përcaktuar rendin e saj të ditës.
- 18.3 Thirrja bëhet 3 (tre) ditë para mbledhjes, me anë të një letre, telegrami, teleksi apo telefaksi. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës konsiderohet e thirrur në mënyrën e duhur edhe nëse nuk janë respektuar formalitetet që rregullojnë procedurën e thirrjes, me kusht që të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të jenë të pranishëm apo përfaqësuar me prokurë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 18.4 Çdo thirrje përmban rendin e ditës të propozuar të mbledhjes.
- 18.5 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çfarëdo vendi tjetër të treguar në thirrje.
- 18.6 Vendimet dhe/ose proces-verbalet mbahen nga sekretari dhe nënshkruhen nga ai dhe Kryetari i Këshillit Mbikqyrës.

- 18.7 Këshilli Mbikqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa praninë e të paktën gjysmës së anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në raste votash të barabarta, vota e Kryetarit është përcaktuese.

Neni 19 - Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

- 19.1 Këshilli Mbikqyrës ka për detyrë hartimin e politikave të Shoqërisë dhe mbikqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë; gjithashtu ai do të ketë të gjitha kompetencat e parashikuara nga nenet 103, 122, 123 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, me ndryshimet përkatëse.
- 19.2 Këshilli Mbikqyrës është përgjegjës për kontrollin e vazhdueshëm të politikave dhe aktivitetit të Shoqërisë si edhe ka të gjitha detyrat dhe kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
- 19.3 Këshilli Mbikqyrës emëron anëtarët e Drejtorisë.
- 19.4 Këshilli Mbikqyrës ka përgjegjësinë të sigurojë që aktivitetet dhe funksionimi i Shoqërisë janë në përputhje me ligjin. Ai rishikon dhe mbikqyr çdo situatë aktuale apo të mundshme konflikti interesash dhe, në përputhje me ligjin, merr prej anëtarëve të Drejtorisë të gjitha njoftimet e konflikteve aktuale apo të mundshme të interesave që ata mund të kenë me Shoqërinë. Këshilli Mbikqyrës nxjerr udhëzime në lidhje me ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit për informacionet në lidhje me Shoqërinë si dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- 19.5 Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të kryejë të gjitha verifikimet dhe mbikqyrjet që i quan të përshtatshme për përmbushjen e detyrave të tij.
- 19.6 Këshilli Mbikqyrës i paraqet Asamblesë së Zakonshme komentet e tij mbi raportin vjetor të përgatitur nga Drejtoria dhe mbi llogaritë vjetore të vitit financiar, sipas legjislacionit në fuqi.
- 19.7 Këshilli Mbikqyrës, ndër të tjera, mbikqyr aktivitetin e Drejtorisë, miraton kriteret e marrjes në punë, vendet e punës dhe shpërblimet e punonjësve të shoqërisë dhe jep autorizimin për lidhjen e marrëveshjeve që kërkojnë autorizim në bazë të ligjit.

SEKSIONI V DREJTORIA

Neni 20 – Drejtoria


- 20.1 Shoqëria drejtohet nga një Drejtori e përbërë nga një numër prej 1 (një) ose 3 (tre) Drejtorësh, të cilët mund të jenë ose jo aksionerë, të emëruar nga Këshilli Mbikqyrës. Drejtori i parë dhe i vetëm i Shoqërisë është:
- Z. Genond Mesareja, qytetar shqiptar, lindur në Tirane, më 21 Korrik 1969, banues në Tirane, mbajtës i pasaportës me nr. Z1379870.
- 20.2 Anëtarët e Drejtorisë emërohen për një afat 3 (tre) vjeçar me të drejtë rizgjedhje.



- 20.3 Kryetari i Drejtorisë ose Drejtori i Vetëm përfaqëson ligjërisht Shoqërinë.
- 20.4 Përfaqësuesit e mësipërm ligjorë të shoqërisë mund të emërojnë një përfaqësues "*ad negotia*" për ushtrimin e detyrave apo kategorive të detyrave të veçanta, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.
- 20.5 Këshilli Mbikqyrës vendos shpërblime për anëtarët e Drejtorisë në momentin e emërimit të tyre.
- 20.6 Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga Këshilli Mbikqyrës në çdo kohë për arsye të ligjshme, në bazë të ligjit.
- 20.7 Në rast të ndonjë vendi vakant në Drejtori për shkak vdekje, dorëheqje, shkarkimi, mungese kualifikimi apo çdo shkak tjetër, pasardhësi zgjidhet nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen më të parë të tij pas krijimit të vendit vakant. Anëtari i Drejtorisë, i emëruar për të zëvendësuar një anëtar tjetër, qëndron në detyrë për të gjithë kohën e mbetur të mandatit të anëtarit paraardhës.

Neni 21 – Mbledhja e Drejtorisë

- 21.1 Në rast se numri i anëtarëve të Drejtorisë është më shumë se një sipas nenit 20.1 zbatohen dispozitat e mëposhtme.
- 21.2 Kryetari thërret mbledhjen e Drejtorisë, duke përcaktuar rendin e ditës, në çdo kohë që e quan të nevojshme apo në rast se ai merr një kërkesë me shkrim nga të paktën një anëtar i Drejtorisë. Kërkesa duhet të përmbajë listën e çështjeve apo temave që duhen diskutuar. Në rast se Kryetari refuzon të thërrasë mbledhjen, mbledhja mund të thirret nga personi kërkues, i cili përcakton rendin e ditës.
- 21.3 Drejtoria do të thirret me anë të një letre rekomande, telegrami ose telefaksi të dërguar të paktën 3 (tre) ditë përpara mbledhjes. Në rast se Kryetari mungon ose për ndonjë arsye nuk ka mundësi të marrë pjesë në mbledhje, të gjitha funksionet e përcaktuara në këtë nen i transferohen Zëvendës Kryetarit, nëse ka, ose Drejtorit më të vjetër në detyrë. Drejtoria do të mbledhet në mënyrë të vlefshme edhe nëse nuk është bërë njoftimi formal i thirrjes, me kusht që të gjithë Drejtorët të jenë të pranishëm.
- 21.4 Drejtoria mund të emërojë një Sekretar për të mbajtur prçes-verbalin. Sekretari mund të jetë edhe një person i cili nuk është anëtar i Drejtorisë.
- 21.5 Vendimet dhe/ose proceverbalet e Drejtorisë nënshkruhen respektivisht nga Kryetari apo zëvendësi i tij.
- 21.6 Mbledhjet e Drejtorisë do të zhvillohen të paktën një herë në tre muaj, në selinë e Shoqërisë apo në ndonjë vend tjetër, në Shqipëri apo jashtë saj; ato mund të zhvillohen edhe me telekonferencë apo videokonferencë, apo me mjete të tjera elektronike, me kusht që të gjithë të pranishmit të jenë të identifikueshëm dhe tu jipet mundësia për të



ndjekur diskutimet dhe marrë pjesë në to. Në këtë rast, Drejtoria do të konsiderohet se zhvillon mbledhjen në vendin ku ndodhet Kryetari dhe/ose zëvendësi i tij dhe Sekretari, me qëllim që të bëhet e mundur hartimi dhe nënshkrimi i vendimit dhe/ose proceverbalit përkatës.

- 21.7 Mbledhjet e Drejtorisë quhen të mbledhura në mënyrë të vlefshme kur janë të pranishëm shumica e Drejtorëve. Vendimet e Drejtorisë janë të vlefshme kur miratohen me votën *pro* të shumicës së Drejtorëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit është përcaktuese.

Neni 22 – Kompetencat e Drejtorisë

- 22.1 Drejtoria ka të gjitha kompetencat në lidhje me administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji apo Statuti ia rezervon organeve të tjera. Drejtoria i nënshtrohet mbikqyrjes dhe kontrollit të Këshillit Mbikqyrës.
- 22.2 Drejtoria mban llogaritë e duhura dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me ligjin. Drejtoria i paraqet një raport Këshillit Mbikqyrës të paktën një herë në tre muaj. Drejtoria i paraqet Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore të paktën brenda tre muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.
- 22.3 Drejtoria mund të:
- a) angazhojë Shoqërinë në transaksione apo operacione tregtare (psh. shitje, blerje, qiramarrje, etj.) që kalojnë vlerën prej 3.000.000 Leke (tre milion), vetëm me miratimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës;
 - b) angazhojë Shoqërinë në transaksione apo operacione financiare (psh. hua, etj.) që kalojnë vlerën prej 3.000.000 Leke (tre milion), vetëm me miratimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës.

TITULLI VI KONTROLLI, PERIUDHA E KONTABILITETIT, LLOGARITË VJETORE, FITIMET

Neni 23 – Kontrollorët

- 23.1 Kontrolli i brendshëm i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, dhe në mungesë të tij nga zëvendësuesi i tij, të cilët emërohen nga Asambleja e Zakonshme për një vit financiar
- 23.2 Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi:

Ekspert kontabël i autorizuar është: Bujar Bendo, qytetar shqiptar, lindur në Lushnje, më 02 Korrik 1966, banues në Rr. Perlat Rexhepi, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës me nr. Z1111038 dhe me licencë profesionale nr. 79, datë 20 Maj 2000.



Neni 24 - Viti Financiar – Inventari – Llogaritë Vjetore

- 24.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti, përveç rastit të vitit të parë financiar i cili fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.
- 24.2 Drejtoria mban një regjistër të rregullt të pasurisë dhe të aktivitetit të tij, në përputhje me ligjin. Në fund të vitit financiar, Drejtoria harton inventarin e pasurisë deri në këtë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.

Neni 25– Rezultati i Vitit Financiar – Përcaktimi i Fitimit

- 25.1 Drejtoria harton bilancin vjetor në përputhje me ligjin. 5% (pesë përqind) e fitimit neto që rezulton nga bilanci i miratuar, ose nëse parashikohet ndryshe përqindja minimale e kërkuar në bazë të dispozitave ligjore mbahet për rezervën e domosdoshme deri sa kjo rezervë të arrijë 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 25.2 Fitimi i mbetur shpërndahet pas miratimit të llogarive vjetore në bazë të vendimit të Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve.

Neni 26 – Likuidimi dhe Shpërndarja – Ndarja – Bashkimi

- 26.1 Shoqëria quhet e shpërndarë në rastet e parashikuara në ligj. Në rast shpërndarje, mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve emëron një apo më shumë likuidatorë, duke u dhënë atyre kompetencat përkatëse.
- 26.2 Shoqëria mund gjithashtu të ndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

Neni 27 - Dispozitë Përfundimtare

Për ç'farë nuk parashikohet në këtë Statut, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi mbi shoqëritë tregtare.

Palët deklarojnë se ky Statut është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre, dhe e nënshkruajnë atë në praninë time, Noteres, në datën e sotme, me vullnetin e tyre të plotë e të lirë, dhe unë Noterja vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Për: UNION GRUP SH.P.K.


Niko Leka

UNION GRUP SH.P.K.
Rr. Bul. Zvezda 2, 54100, Tiranë
TIRANë - ALBANI
NIPT K 61527801 R

NOTERE





NOTERE
ARIANA R. MALLKUÇI
Të. Z. 250253.266242